



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR FURNIZIM

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj. Zizë Bujupaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë;

Dhe

KONTRAKTORI N.T.P."GRESA COMMERC" Komuna e Prizrenit, të cilën e përfaqëson z. Sahit Bajrami, me Nr. Rexh. Biznesi, 80375263 (në vazhdim "Kontraktuesit"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

FURNIZIMI ME PELET PER NEVOJA TE SHTEPISE PER KOMUNITETE - GURRAKOC

Nr. I prokurimit	633-018-7398-1-3-6/C160
Nr. I brendshëm	633 / 018 / 074 -136

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **FURNIZIMI ME PELET PER NEVOJA TE SHTEPISE PER KOMUNITETE -GURRAKOC**

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi i punëve për aktivitetin e prokurimit:

: **FURNIZIMI ME PELET PER NEVOJA TE SHTEPISE PER KOMUNITETE - GURRAKOC**

është ; 4 300,00 € dhe me fjalë: /katërmije e treqindë euro/euro/ €

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veganta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbehet nga dokumentet në vijim:

Marëveshja e kontratës;
Kushtet e Veganta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
Plani për menaxhimin e kontratës

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbejnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën, dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veganta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashtrohet për dhënie e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në



njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të

interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për: Autoritetin Kontraktues:

Për: Kontraktuesin:
N.T.P."GRESA COMMERC

Emri:	Zizë Bujupaj	Emri:	Sahit Bajrami
Pozita:	Zyrtar Përgjigjës i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	14.11.2018	Data:	14.11.2018
Vula		Vula	